Qyteti i Phoinikes gjatë periudhave helenistike dhe romake në dritën e të dhënave të reja arkeologjike

Belisa Muka
Instituti i Arkeologjisë/ Akademia e Shkencave e Shqipërisë
belisa.muka@akad.gov.al / b_muka@yahoo.com

Abstrakt

Që nga viti 2000, *Phoinike* – kryeqendra e Konisë antike – dhe territori përreth saj, janë në qendër të kërkimeve arkeologjike që realizohen në kuadër të bashkëpunimit midis Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Shkencave e Shqipërisë) dhe Universitetit të Bolonjës (Itali). Falë kërkimeve afatgjata dhe sistematike, është e mundur të rindërtohen linjat kryesore të zhvillimit urban dhe arkitekturor të qytetit të *Phoinike*-s, që nga periudha helenistike deri në atë romake, si dy prej periudhave kryesore që janë fokusi i këtij kontributi. Gjatë një harku kohor, që nis nga fundi i shek. V dhe fillimi i shek IV p.e.s. dhe, që shtrihet deri në gjysmën e dytë të shek. IV e.s., *Phoinike* paraqitet si një qytet i konsoliduar i Kaonisë, me ndërtesa publike, struktura monumentale, zona banimi të sofistikuara dhe një nekropol të organizuar. Kërkimet arkeologjike sistematike kanë zbuluar gradualisht dhe, vijojnë të plotësojnë gjithnjë e më shumë, peizazhin urban të kësaj qendre. Ky kontribut, duke u mbështetur në të dhënat më të reja të kërkimeve arkeologjike, përpiqet të hedhë dritë mbi kuptimin e dinamikave urbane dhe arkitektonike të qyteteve provinciale, në periudha të ndryshme historike në rajonin e Epirit, përkatësisht të një qendre të rëndësishme siç është *Phoinike*.

Fjalë kyçe: *Phoinike*, *Kaonia, periudha helenistike, periudha romake, Epiri.*

Qyteti antik i *Phoinike*-s ndodhet në kodrën e Finiqit, në lindje të fshatit me të njëjtin emër. Sipas Strabonit (VII 7.5), ai ndodhej pranë Gjirit të *Bouthrotos*, në rajonin antik të Kaonisë në Epir.[1] Pozita gjeografike shumë e favorshme i mundësonte njëherazi dominimin mbi fushën e Vurgut, kontrollin e rrugëve natyrore që vinin nga territori i Antigonesë, si dhe dalje në det falë afërsisë me bregdetin, vetëm 7 km nga porti i *Onchesmos*-it, qyteti i sotëm i Sarandës (Fig. 1).

ISSN 3027-5024 (Online)
DOI: https://doi.org/10.62303/jxb9rk48



Fig. 1: Territori i Kaonisë antike me lokalizimin e *Phoinike* (përpunoi Vittorio Mirto)

Rrënojat e *Phoinike*-s në përgjithësi dhe, veçanërisht fortifikimet, kanë tërhequr vëmendjen e udhëtarëve që nga shekulli XVIII. W.M. Leake, gjatë udhëtimit të tij nëpër Shqipëri, përshkruan linjën e fortifikimit dhe lokalizon teatrin (Leake 1835, 66). Kërkimet e para arkeologjike u ndërmorën nga arkeologu italian L.M. Ugolini në vitet 1926-1927, duke nxjerrë në dritë disa monumente (Ugolini 1932).[2] Më tej, gërmimet kanë vijuar nga arkeologë shqiptarë, me disa shkëputje, gjatë viteve 1980-1981 dhe 1989-1990 (Budina 1986, 113-118; Nanaj 1989, 272-273; Nanaj 1990, 265-266). Që prej vitit 2000, qyteti i *Phoinike*-s – kryeqendra e Kaonisë antike dhe territori përreth, janë objekt i kërkimeve sistematike në kuadër të një projekti të përbashkët shqiptaro-italian.[3] Rezultatet e kërkimeve afatgjata dhe sistematike kanë mundësuar një rivlerësim të qartë të zhvillimeve urbane të qytetit, në periudhat helenistike dhe romake[4] (Fig. 2).

Autori i parë i lashtësisë që përmend rajonin e Kaonisë dhe kaonët është Tukididi (II 80.5), në kuadër të ngjarjeve të vitit 429 p.e.s., gjatë Luftës së Peloponezit. Ai i përshkruan kaonët (II 81.4) si "barbarë" dhe si luftëtarë të shquar. Straboni (VII 7.5) thekson se "popujt më të famshëm të Epirit janë kaonët dhe molosët, pasi dikur kanë sunduar me radhë mbi Epirin - fillimisht kaonët, e më pas molosët." Gjatë viteve 297-272 p.e.s., në periudhën e mbretërimit të Piros, kaonët integrohen në koinonin e epirotëve (Cabanes 1995, 138-139; Cabanes 2008, 100-101), ndërsa qendra e tyre kryesore urbane ishte *Phoinike*.

Pirateria detare e ilirëve, gjatë dekadave të fundit të shekullit III p.e.s., nuk e kurseu as qytetin *Phoinike*-s, i cili ndodhej vetëm disa kilometra larg bregdetit të Jonit. Në

vitin 230 p.e.s., pas tradhëtisë së mercenarëve keltë, të cilët e ruanin qytetin (Polibi II 5–6), *Phoinike* kaloi për një kohë të shkurtër në duart e ilirëve (Hammond 1967, 595 *et passim*; Cabanes 1976, 200, 208 *et passim*; Cabanes 1995, 40; De Maria 2002, 13). Sipas Polibit (II 8.4), mbretëresha ilire Teuta, kur anijet e saj u kthyen nga Epiri, u mahnit nga cilësia dhe bukuria e plaçkës së luftës, "sepse *Phoinike* ishte atëherë qyteti më i begatë i Epirit." Në kuadër të paqes së vitit 205 p.e.s., e cila i dha fund luftës së parë maqedonase - konflikt që vuri përballë mbretin Filip V, aleat i Hanibalit dhe romakët, aleatë të etolëve - qyteti i *Phoinike*-s rifitoi rëndësinë e tij. Sipas Tit Livit (XXIX 12.11), Filipi V zhvillon bisedime brenda mureve të qytetit të *Phoinike*-s me tre praetorët e koinonit të epirotëve; pala romake përfaqësohej nga gjenerali romak P. Sempron (Cabanes 2008, 101). Viti 170 p.e.s. shënon një përçarje brenda koinonit të epirotëve. Pas fitores së Paul Emilit në Pydna në vitin 168 p.e.s., Epiri në tërësi pësoi dëme të rënda: krahinat e tij jugore u shkatërruan dhe 150 000 banorë u morën robër. Gjatë viteve 158 dhe/ose 157 p.e.s., siç rrëfen Polibi (XXXII 5–6), qytetet epirote u bënë objekt i dhunës dhe i masakrave të Karopsit të Ri (Cabanes 1976, 303).

Fig. 2: Pamje nga jugu e kodrës së *Phoinike*-s (foto autori)

E ndërtuar nga fundi i shek. V deri në fillimin e shek. IV p.e.s. (Cabanes 1988, 206), *Phoinike* që nga mesi i shek. IV ishte qendra politike e Kaonëve. Emri i saj përmendet për herë të parë në listën e *thearodokoi* të Argosit, që daton rreth viteve 330 p.e.s. (SEG 23 189). Kjo përmendje, zëvendëson emrin e Kaonëve që shfaqet në listën e *thearodokoi* të Epidaurit, e cila i paraprin asaj të Argosit dhe që datohet një brez më herët, rreth viteve 365–359 p.e.s. (Cabanes 1976, 116). Hyjnia mbrojtëse duket se ishte *Athena Polias* (SEG 15 397.4). Një pllakë orakullare prej plumbi, e zbuluar në faltoren e Dodonës dhe që datohet, mbi baza paleografike, rreth viteve 330-320 p.e.s., mban mbishkrimin «πόλις τῶν Χαόνων», i cili nga disa studiues i është atribuar *Phoinike*-s (Dakaris *et al*. 1993, 58-59), ndërsa nga të tjerë lidhet me bashkësinë politike të Kaonëve (Larsen 1968, 280; Cabanes 1999, 374; Lhôte 2006, 60-61; Cabanes 2007, 233; Quantin, Quantin 2007, 176; Cabanes 2008, 100; Bogdani). Bashkësia, apo *koinon*-i kaon, e organizuar si etnos, karakterizohet nga dy qendra kryesore, *Phoinike*,

kryeqendër, në pellgun e Delvinës dhe Antigonea, në luginën e Drinosit (Budina 1972), të cilat zhvillohen në kuadër të koinonit, kanë territoret e tyre bujqësore përreth dhe kalatë apo pikat e vrojtimit, që kontrollonin luginat dhe vendkalimet kryesore.[5] Këto qendra, nuk u bënë asnjëherë qytet-shtete sipas formatit të njohur të *polis*-it autonom,[6] siç është rasti i dy prej ngulimeve koloniale korinto-korkyrase, në brigjet lindore të Adriatikut, Apollonia dhe Epidamne-Dyrrahu, por e ruajtën këtë formë organizimi deri në pushtimin romak (Cabanes 2008, 65, 98).

E konsideruar nga Polibi si *polis* (II 5.5; II 8.4) në kuptimin urban, *Phoinike* ishte e pajisur me një sistem mbrojtës të jashtëzakonshëm. Historiani (II 1–8) e cilëson atë si "qyteti më i fortifikuar dhe më i fuqishëm i Epirit". Gjatë periudhës helenistike, në kohën e kulmit të tij, sipërfaqja *intra muros* arrinte në rreth 57 hektarë (Funke *et al*. 2004, 348).

Kërkimet e deritanishme dëshmojnë se, sektori lindor, me shumë gjasë për shkak të pozicionit strategjik të favorshëm mbi fushën e Vurgut, përbën zonën më të hershme të banuar në kodër. Edhe pse dëshmitë arkeologjike për këtë fazë janë të pakta, për shkak të mbivendosjeve të mëvonshme dhe vazhdimësisë së aktivitetit njerëzor në kodër, deri në fundin e viteve '80 të shekullit të shkuar,[7] muret rrethuese në sektorin lindor (**Fig. 3**), të ndërtuar me paret unik dhe blloqe të mëdha – një teknikë ndërtimi më e hershme –, përfaqësojnë një nga elementët kryesorë të kësaj periudhe,[8] Nga nekropoli jugor janë zbuluar struktura funerare, si varre me vendosje trupi ashtu edhe me djegie, të datuara në mesin e shek. IV p.e.s. Megjithatë, këto nuk mund të lidhen me siguri me strukturat në qytetin e sipërm.[9] Sidoqoftë, shpërndarja e varreve përgjatë akseve rrugore, që lidhen drejtpërdrejtë me qytetin e sipërm, sugjeron një ndërveprim midis kodrës dhe qytetit të poshtëm.

Fig. 3: Muret rrethuese pranë *Laurus Nobilis* (foto nga arkivi projektit shqiptaro-italian)

Një strukturë urbane e mirëfilltë konstatohet në sektorin lindor, falë pranisë së dy rrugëve kryesore që e përshkojnë atë. Këto rrugë e lidhin këtë sektor në veri, nëpërmjet portës F, me zonën e Matomarës,[10] ndërsa e hapin drejt jugut nëpërmjet portës A pranë *Laurus Nobilis*. Në këtë zonë, ndodhej *archaia agorà* – hapësira publike më e hershme – e cila, në periudhat e mëvonshme, u zëvendësua nga një agora e re – *nea agorà* – në sektorin perëndimor (Lepore 2022). Në fund të shek. III dhe fillim të shek. II p.e.s., qyteti zgjerohet drejt perëndimit me ndërtimin e një muri të ri fortifikues, të realizuar sipas teknikës *emplecton*. Ky zhvillim e pozicionon *Phoinike*-n si një *polis* me karakteristika të qarta arkitekturore, tipike të periudhës helenistike (Fig. 4).



Fig. 4: Planimetria e Phoinike-s me monumentet kryesore: Struktura ndërtimore (1); Stoa lindore - zona e sektorit lindor (2); Çisternë (3); Teatri (4); Banesa me dy peristile (7); Banesa me afresk (8) (arkivi projektit shqiptaro-italian)

Agoraja e vjetër - *archaia agorà* - në fillimi të shek. II p.e.s., pajiset me një stoa monumentale (50 m × 12 m), me orientim veri-jug. Struktura është dynefëshe dhe përfshin një sallë qendrore katërkëndëshe (Fig. 5), e cila mund të ketë patur funksione publike dhe kultuale (Rinaldi 2023, 87-90). Fasada perëndimore ishte e pajisur me kolonadë e stilit dorik, elementët arkitekturorë të së cilës janë ripërdorur në ndërtimet e periudhës mesjetare.[11]

Në të njëjtin sektor janë dokumentuar fragmente të shumta arkitektonike, përfshirë një mbishkrim monumental për nder të banorëve të Ambrakisë,[12] një dëshmi e rëndësishme për funksionet publike të zonës dhe ndërveprimet e qytetit me hapësirën përreth (Fig. 6).

Qyteti i periudhës helenistike karakterizohet nga prania e dy monumente të rëndësishme publike, në njërën anë teatri dhe, në anën tjetër agoraja e re, me tërësinë e strukturave që e përbëjnë. Në perëndim, në një kavitet natyror, shtrihet teatri madhështor, i ndërtuar në dy faza (Fig. 7), që kronologjikisht vendosen midis shekujve III-II p.e.s. (Villichich 2018). Ky teatër ka shërbyer si hapësirë për mbledhjet komunitare, si edhe për zhvillimin e aktiviteteve me karakter kulturor dhe ndoshta religjioz (Lepore 2019). Mendohet se edhe traktati i njohur si "Paqja e *Phoinike*-s", i vitit 205 p.e.s., që i dha fund Luftës së Parë Maqedonase (Cabanes 2008, 101), mund të jetë firmosur pikërisht në teatrin e qytetit. Në pjesën e sipërme të tij, në *summa cavea*, duhet të ketë ekzistuar një hapësirë me karakter kultual, siç sugjeron prania e disa mbishkrimeve.

Fig. 5: Stoa në agoranë e vjetër (foto nga arkivi i projektit shqiptaro-italian)

Fig. 6: Mbishkrimi i fragmentuar, kushtuar banorëve të Ambrakisë në agoranë lindore (foto nga arkivi i projektit shqiptaro-italian)

Ndër to veçohet një kushtim për Poseidonin, i datuar në gjysmën e dytë të shek. III p.e.s., i bërë nga skllavi i liruar Dazos, ndonëse ky dokument epigrafik është zbuluar në një kontekst dytësor (Ugolini 1932, 147-148; *CIGIME* III, nr. 8, 40-43).

Fig. 7: Pamje e teatrit nga sipër (foto autori)

Agoraja e re - *nea agora* - përbën një ansambël monumental, i organizuar në tri tarraca që zbresin nga veriu drejt jugut.[13] Tarraca e parë, e shtrirë përgjatë kreshtës veriore të kodrës, edhe pse e dëmtuar masivisht nga ndërhyrjet ushtarake të shek. XX, mendohet të ketë akomoduar një ndërtesë të rëndësishme, ndoshta me karakter religjioz. Në tarracën e dytë, e cila ka një shtrirje të konsiderueshme, është zbuluar një stoa e re njënefëshe (32 m × 4.4 m) me eksedër fundore, si dhe një shesh publik i rrethuar me kolonadë, me funksione të mundshme religjioze.[14] Në perëndim të stoas ndodhet një ndërtesë tjetër katërkëndëshe (13 m × 15.5 m), e pajisur me kontrafortë, e cila mund të ketë pasur funksione administrative ose është përdorur për mbledhje. Tipologjikisht, ajo paraqet ngjashmëri me struktura të ngjashme të dokumentuara në Epir dhe Iliri[15] (Fig. 8).

Tarraca e tretë, që ndodhet në skajin jugor dhe është ende në proces gërmimi, shtrihet në një sipërfaqe prej rreth 400 m^2 dhe shfrytëzon në mënyrë të sofistikuar terrenin natyror. Ajo përfaqëson pikën lidhëse, si në aspektin urban ashtu edhe në atë simbolik, midis qytetit të vjetër dhe lagjes së re publike, e cila bashkonte funksione politike dhe religjioze. Një sistem rrugësh të vogla me orientim lindje-perëndim mundëson qarkullimin në këtë zonë. Pikërisht në këtë tarrracë ndodhen disa monumente të rëndësishme publike të periudhës romake, që ngrihen mbi të paktën dy tarraca më të vogla të periudhës helenistike,[16] të ripërshtatura për të akomoduar një fazë të re dhe të rëndësishme ndërtimore të qytetit.

Zhvillimi urban i periudhës helenistike plotësohet nga dy zona të rëndësishme banimi, të cilat shtrihen në pjesën jugore të kodrës – zonë e cila, sipas të gjitha gjasave, është konceptuar që në fillesat e saj si pjesë e një procesi tërësor planifikues.[17]



Fig. 8: Agoraja e re: tri tarracat dhe dy rrugët (strada 1 dhe strada 2), që e përshkojnë në drejtimin lindje-perëndim; Çisternat (3, 5); Teatri (4); Bazilika (9); me ngjyrë të errët, janë evidentuar strukturat e periudhës helenistike (arkivi i projektit shqiptaro-italian)

E para, e njohur si "banesa me dy peristile", përbëhet nga dy tarraca të mëdha me oborre që rrethohen nga kolona (Çondi *et al.* 2002). Gërmimet e përbashkëta shqiptaro-italiane kanë sqaruar se kemi të bëjmë me një rezidencë të madhe, ndërtimi dhe përdorimi i së cilës shtrihet kronologjikisht nga periudha helenistike (shek. III-II p.e.s.) deri në antikitetin e vonë (Fig. 9). Rivlerësimi i këtij kompleksi përmes një analize të kujdesshme, që merr në konsideratë shtrirjen hapësinore, kontekstin dhe funksionin e tij, lejon – ose të paktën nxit – reflektimin për një funksion të mundshëm të "banesës me dy peristile", që zhvendoset nga dimensioni "publik" drejt një dimensioni "privat."[18] Kështu, në aspektin topografik, "banesa me dy peristile" lokalizohet në kufijtë e zonës qendrore të qytetit; ndërkohë, përveç hapësirave të banimit, dokumentohet edhe prania e mjediseve që mund të kenë pasur edhe funksione të tjera komunitare. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë praninë e objekteve që i përkasin sferës kultuale, përfshirë gjetje koroplastike, objekte në miniaturë dhe një skulpturë që paraqet një hyjni.[19] Ndër to spikat edhe prania e strukturave për depozitimin e ujit, si çisternat, duke treguar rëndësinë e ujit si element thelbësor në praktikat rituale, në kontekstin e ceremonive që zhvilloheshin në kuadër të kulteve private, publike ose gjysmë-publike.[20]

Fig. 9: Banesa me dy peristile (foto nga arkivi i projektit shqiptaro-italian)

E dyta, "banesa me afresk" (C4), ndodhet në shpatin jugor të kodrës (Gorica 2015), me pamje drejt bregdetit, në një zonë periferike të qytetit, në raport me agoranë e re (Fig. 10). Ajo lidhet me pjesën tjetër të qytetit, nëpërmjet rrugës kryesore me drejtim lindje-perëndim, që përshkon pjesën e sipërme të kodrës. Emërtimi i kësaj banese i detyrohet një zbulimi të rrallë për kontekstin epirot, një dekor stukoje polikrome, i cili ishte shkëputur nga muri që vishte dhe u gjet i rrëzuar mbi dysheme. Gjurmë të tjera të këtij dekorimi janë ende të dukshme në një prej ambienteve të tjera të banesës. Ky lloj dekori, me karakter strukturor, përfaqëson një formë të përhapur të artit mural dhe i përket të ashtuquajturit *Stili i parë*. Kompleksi, që është aktualisht objekt i një ritrajtimi të plotë (Benfatti, Muka në shtyp), ruan dekore murale me rëndësi, përfshirë shembullin më të hershëm të "stilit strukturor" të identifikuar deri më tani në *Phoinike*.

Sa i përket qytetit në periudhën romake,[21] bazuar kryesisht në të dhënat që vijnë nga kërkimet e Ugolinit, i cili ka dokumentuar një numër të konsiderueshëm strukturash në qytetin e poshtëm, për një periudhë të gjatë është menduar se kjo fazë e vendbanimit ishte zhvendosur në zonën ku sot shtrihet fshati modern i Finiqit. Në kodër, monumentet e kësaj periudhe lidhen kryesisht me praninë e cisternave të identifikuara nga Ugolini (Ugolini 1932, 77), si dhe me një strukturë katërkëndore, të ndërtuar me teknikën *opus incertum*, e cila me shumë gjasë përfaqëson një tjetër cisternë. Kjo e fundit është dokumentuar në pjesën e poshtme të skenës së teatrit, përgjatë shpatit që zbret drejt fshatit Finiq (Lepore 2023, 198).

Fig. 10: Banesa me afresk (foto nga arkivi i projektit shqiptaro-italian)

Në qytetin e poshtëm, nekropoli jugor përjeton një fazë të rëndësishme gjatë periudhës romake (Fig. 11), gjatë të cilës vërehet si përshtatja e praktikave dhe riteve funerare sipas normave të reja të kohës, ashtu edhe një rikonceptim i organizimit të përgjithshëm të hapësirës funerare, i reflektuar në ndërtimin e disa monumenteve të reja dhe në risistemimin e infrastrukturës së qarkullimit të brendshëm (Lepore, Muka 2018, 19-20; 295-296; 301-302; 309-310).



Fig. 11: Nekropoli jugor dhe organizimi i brendshëm i tij (arkivi i projektit shqiptaro-italian)

Paralelisht, me rëndësi janë rrënojat që duket se i përkasin një *aquaduct*-i, të cilat ndjekin rrjedhën e lumit të Bistricës dhe karakterizohen nga përdorimi i teknikës *opus incertum* me rradhë horizontale tullash[22] (Fig. 12). Ndonëse kjo strukturë, me gjendjen e ruajtjes që paraqet sot, nuk tregon gjurmë të arkadave ku duhej të lokalizohej *specus*-i, ajo paraqet disa kontrafortë dhe shtresëzime gëlqerore në pjesën e sipërme, elemente që duket se hedhin dritë mbi një funksion të përbërë si mur mbajtës dhe njëherazi, si

strukturë mbështetëse për një kanal të sipërm, nëpër të cilin rridhte uji (Lepore 2023, 196).

Fig. 12: Struktura murale e *aquaduct*-it (foto nga arkivi i projektit shqiptaro-italian)

Gjatë periudhës romake vijon përdorimi i një prej monumenteve më të rëndësishme publike të qytetit, teatri, i cili i nënshtrohet ndërhyrjeve dhe modifikimeve të konsiderueshme (Villicich 2018). Në të njëjtën kohë, hapësira e banimit pëson transformime të dukshme, siç tregojnë ndryshimet e dokumentuara arkeologjikisht në "banesën me dy peristile". Krahas bërthamës kryesore në lindje, strukturës së saj i shtohet një tarracë e re në perëndim, duke krijuar kështu një ndërtesë me përmasa të konsiderueshme dhe me disa nivele të ndryshme, jo vetëm në hapësirat e banimit, por edhe në funksionet e saj (Giorgi *et al.* 2005). Prania e ambienteve shtesë, me karakter prodhues dhe artizanal, i jep kompleksit një dimension të ri dhe të rëndësishëm ekonomik.

Të dhënat kryesore mbi aktivitetin ndërtimor të periudhës romake janë identifikuar gjatë kërkimeve arkeologjike të viteve të fundit në kodrën e Finiqit, pikërisht aty ku shtrihet qyteti i sipërm. Falë këtyre kërkimeve, është e qartë se agoraja e re e qytetit të periudhës helenistike u bë hapësira në të cilën, gjatë periudhës romake, zhvendoset zemra e qytetit. E organizuar në disa tarraca në jug të bazilikës së madhe, sektori i emërtuar A11 përbëhet në dy monumente publike të përmasave të mëdha: kriptoportiku dhe "ndërtesa me nënstruktura" (Fig. 13).

Fig. 13: Ansambli monumental me kriptoportikun dhe ndërtesën me nënstruktura (foto nga arkivi i projektit shqiptaro-italian)

Në tarracën e poshtme të ansamblit monumental shtrihet kriptoportiku, i përbërë nga një mur i madh tarracimi me disa hapje në formë dritaresh në fasadë, i orientuar drejt lagunës së Butrintit në jug. Ai është ndërtuar me teknikën *opus incertum* dhe përmban breza të përbërë nga tri radhë me pllaka guri gëlqeror të bardhë (Benfatti, Patrignani 2023, 32-33; 40). Shembuj të ngjashëm dokumentohen edhe në ndërtime të periudhës romake në Butrint apo *Nicopolis* (Benfatti 2023, 19-24). Tarraca e sipërme përbëhet nga e ashtuquajtura "ndërtesa me nënstruktura", e pajisur me kthina në të katër anët e saj dhe me një sipërfaqe prej rreth 500 m^2. Kjo ndërtesë lidhet me aksin kryesor rrugor të qytetit të sipërm, me drejtim lindje-perëndim, në veri të të cilit ndodhet bazilika e madhe. Edhe pse funksioni i këtyre strukturave nuk është ende i qartë, të dhënat stratigrafike dëshmojnë se të dy monumentet janë ndërtuar në të njëjtën kohë, gjatë periudhës perandorake, konkretisht nga periudha augustiane deri në fundin e shek. II të e.s. Një element i rëndësishëm që hedh dritë edhe mbi praninë e një hapësire me funksion religjioz, që lidhet me kultin e hyjnisë egjiptiane Isis, është zbulimi i një skulpture të fragmentuar (Fig. 14-15), e cila paraqet një figurë femërore me elemente të qarta të ikonografisë isiake (Lepore, Muka 2023, 44-49). Kjo dëshmi, e para në llojin e saj jo vetëm nga *Phoinike*, e pozicionon qytetin ndër qendrat e rëndësishme të territorit që kanë ofruar dëshmi për praninë e kulteve isiake gjatë periudhës romake.[23]

Fig. 14: Gjatë punës për zhvendosjen e skulpturës (foto nga arkivi i projektit shqiptaro-italian)

Fig. 15: Pamje e skulpturës nga ana e përparme dhe e pasme (foto nga arkivi i projektit shqiptaro-italian)

Gjatë shek. II të e.s., ansambli monumental i qytetit i nënshtrohet disa restaurimeve, duke dëshmuar vazhdimësinë e funksionimit të tij pa ndërprerje deri në vitin 358 e.s.,[24] kur një tërmet i fuqishëm solli shembjen e fasadës së kriptoportikut (**Fig. 16**), si dhe shkaktoi dëmtime të tjera në strukturat e periudhës romake në *Phoinike*. Ndër to përmenden dëmet e konstatuara në zgjerimin që "banesa me dy peristile" ka pësuar

në periudhën romake në sektorin lindor (Giorgi *et al.* 2005, 31-32), si edhe në teatër (Villicich 2018, 116-118). Në periudhën e sundimit të perandorit Justinian hapet një fazë e re ndërtimore, e cila, sipas të gjitha gjasave, përfshinte të gjithë hapësirën e qytetit të sipërm, si pjesë e një projekti më të gjerë transformues të ndërmarrë nga vetë perandori (Benfatti 2023a).

Fig. 16: Gjendja e rrëzimit të blloqeve të mureve jugorë të kriptoportikut (foto nga arkivi i projektit shqiptaro-italian)

Nisur nga kjo pasqyrë e përgjithshme, del në pah imazhi i një qyteti të konsoliduar, si gjatë periudhës helenistike, ashtu edhe gjatë periudhës romake. Në periudhën helenistike, *Phoinike* paraqitet si një *polis* i zhvilluar i Kaonisë, i pajisur me ndërtesa publike, struktura monumentale, zona banimi të sofistikuara, si dhe një nekropol të organizuar me monumente funerare përgjatë akseve rrugore kryesore që lidhnin

qytetin e poshtëm me atë të sipërm – një qendër urbane, peizazhi i të cilit po zbulohet gjithnjë e më e qartë falë kërkimeve arkeologjike sistematike. Në periudhën romake, qyteti dëshmon një vazhdimësi të qartë zhvillimi, si në pjesën e sipërme të kodrës – ku dokumentohen ndërtime publike dhe private – ashtu dhe në qytetin e poshtëm, pa treguar shenja ndërprerjeje pas trazirave që pasuan fitoren e prokonsullit romak *Lucius Aemilius Paullus* në Pidna, në vitit 168 p.e.s. (Cabanes 1976, 303). Përkundrazi, gjatë kësaj periudhe *Phoinike* përjetoi një hov të rëndësishëm ndërtimor, gjurmët më të hershme të të cilit datohen që në kohën e Augustit. Ky zhvillim dallohet qartë në fazën romake të zonës rezidenciale që shtrihet në perëndim, në drejtim të teatrit dhe së fundmi në sektorin qendror, ku është dokumentuar një ansambël monumental që përfshin kriptoportikun dhe të ashtuquajturën "ndërtesa me nënstruktura". Ky proces i intensifikimit ndërtimor shoqërohet gjithashtu me prerjen, nga ana e qytetit, të monedhave gjatë periudhës së perandorit Trajan (Gjongecaj 2011).

Në përfundim, të dhënat arkeologjike të deritanishme dëshmojnë se *Phoinike* ka qenë një qytet me zhvillim të qëndrueshëm urban, gjatë periudhave helenistike dhe romake. Ndërthurja e monumenteve publike, strukturave administrative, hapësirave të banimit dhe atyre funerare, si dhe elementët kulturorë, e rendisin këtë qendër ndër më të rëndësishmet e Epirit, duke ofruar një tablo të qartë të transformimeve politike, shoqërore dhe arkitektonike që përjetuar përgjatë shekujve.

FUNDOTAT

1 Rajoni i Kaonisë shtrihet përgjatë brigjeve të detit Jon dhe përfshin jugun e Shqipërisë, grykëderdhja e lumit *Thyamis* (Kallamas) deri te malet Akrokeraune (Karaburun). Në veri, kufiri me territoret e banuara nga popullsitë ilire përcaktohet nga rrjedha e lumit Aos (Vjosë).

2 Për një përmbledhje historike, shih De Maria 2003-2004.

3 Projekti shqiptaro-italian i *Phoinike*-s është një bashkëpunim midis Institutit të Arkeologjisë dhe Universitetit të Bolonjës, themeluar nga profesorët Shpresa Gjongecaj dhe Sandro De Maria, të cilët e kanë bashkëdrejtuar atë për thuajse dy dekada. Aktualisht, kërkimet bashkëdrejtohen nga Belisa Muka dhe Giuseppe Lepore. Botimet lidhur me kërkimet arkeologjike në *Phoinike* dhe territorin përreth janë të shumta: përveç serisë *Phoinike* (I-VI), e cila përmbledh rezultatet paraprake të fushatave të gërmimeve, ekziston edhe *Serie Monografica,* një seri studimesh monografike mbi tema specifike si territori, dekori arkitekturor, qeramika helenistike, teatri, nekropoli jugor etj. Së fundmi ka nisur udhën e saj edhe seria *Studi Fenichioti* (I-III), ku përfshihet edhe *Phoinike VII.*

4 Në këtë kontribut do të përqendrohemi ngushtësisht në periudhat helenistike dhe romake, megjithëse periudha nga antikiteti i vonë deri në mesjetë ka një rëndësi të veçantë në *Phoinike*. Përmendim këtu kompleksin episkopal dhe kompleksin termal në sektorin perëndimor, kishëzën me funksion funerar në sektorin lindor, si dhe rrënojat e marabutit bektashi, etj. Për një përmbledhje të detajuar rreth kësaj periudhe, shih Benfatti 2023a, 204-214.

5 Në rastin e *Phoinike*-s, kemi disa pika të rëndësishme mbrojtëse, si Vagalat, Karoq, Malçan, Çuka e Ajtoit, apo Borsh etj. Ndërsa në rastin e Antigonesë, Labova, Melan, Selo etj. Për më shumë rreth Kaonisë, shih Giorgi, Bogdani 2012

6 Sipas Larsen 1968, f. 280: "Ka më shumë gjasa që kjo të nënkuptojë shtetin e Kaonëve dhe është një shembull tjetër i prirjes jetëshkurtër të kësaj periudhe për ta zbatuar këtë term për çdo shtet, madje edhe për një shtet federal."
7 Përmendim këtu vendosjen e bazës ushtarake në kodrën e Finiqit, e cila ka lënë gjurmë të thella në rrënojat arkeologjike. Për më shumë shih Muka, Benfatti 2023, 164-182.
8 Gërmimet e deritanishme kanë nxjerrë në dritë një sasi të kufizuar të qeramikës atikase të fundit të periudhës arkaike dhe asaj klasike, e cila vjen nga kontekste dytësore. Edhe pse këto gjetje nuk mund të japin informacion të drejtpërdrejtë mbi përdorimin dhe domethënien që ato kishin në kontekstet parësore, prania e tyre është dëshmi e shkëmbimeve dhe marrëdhënieve midis dy territoreve. Shih, Baldoni 2023, 185-188.
9 Rreth nekropolit jugor të *Phoinike*-s shih Lepore, Muka 2018; për një panoramë më të plotë mbi arkeologjinë funerare në Iliri dhe Epir, shih Lepore, Muka 2020.
10 Rreth kërkimeve arkeologjike të realizuara nga projekti shqiptaro-italian në zonën e Matomarës, shih Bogdani, Giorgi 2011.
11 Për një rikonstruksion hipotetik të *stoas* dhe analizën e materialit ndërtimor të saj, shih D'Aprile, Leone 2023, 91-104.
12 L.M. Ugolini, gjatë gërmimeve në kodrën e Phoinike-s, identifikoi një tjetër fragment që i referohet banorëve të Ambrakisë. Për më shumë, shih Ugolini 1932, 151-152 (fig. 83); Muka 2023, 190-191.
13 Kemi të bëjmë me një hapësirë publike, e cila karakterizohet nga ndërhyrje në terren si nivelime dhe mbushje, me qëllim krijimin e niveleve uniforme të përdorimit.
14 Rreth një sinteze të plotë mbi këtë monument, i cili për një kohë të gjatë është interpretuar si *thesauros*, shih së fundmi Rinaldi 2020.
15 Për më shumë rreth shembujve të ngjashëm në *Kassope* (i ashtuquajturi *prytaneion*), Dodona (*bouleuterion*) dhe Bylis (agora), shih Rinaldi 2015.
16 Këto dy tarraca shfrytëzojnë drejtpërdrejt shkëmbin natyral dhe kanë orientime që ndryshojnë lehtësisht mes tyre, me shumë gjasa për t'iu përshtatur anomalive të ndryshme të terrenit.
17 Rreth hapësirës së banimit në *Phoinike*, shih De Maria, Gorica 2012; De Maria, Gorica 2018.
18 Studimi i konteksteve të ngjashme në Siçili dhe *Magna Graecia* dëshmon domosdoshmërinë e një rishqyrtimi kritik të konceptit të "hapësirës së shenjtë" në antikitet. Ky koncept është shpesh i kufizuar brenda kornizave të kanonizuara të një strukture të qartë tempulli apo sanktuari me rrethimin e tij të shenjtë. Për më shumë mbi këtë qasjeje të re studimore, që sfidon modelin tradicional dhe ku vëmendja përqendrohet gjithnjë e më shumë në analizën e hapësirave hibride dhe praktikave rituale jashtë konteksteve të formalizuara, shih Serino 2021.
19 Gërmimet e vitit 2003 nxorrën në dritë një skulpturë të fragmentuar, e cila paraqet hyjneshën Artemis. Sot, ky objekt, ekspozohet në Muzeun e Butrintit. Për më shumë rreth këtij zbulimi, shih njoftimet e para në *Phoinike III*; De Maria, Mercuri 2007, 165-167.
20 Mbi një ritrajtim të këtij kompleksi banimi, shih Gamberini, Giorgi 2023; më gjerë mbi fenomenin e të ashtuquajturave "case sacre" në Epir, shih Lepore, Muka (në shtyp).
21 Rreth dokumentimit të rrënojave të periudhës romake, shih përmbledhjen e Giorgi,

Bogdani 2012, 397-416 (dhe bibliografinë relative); De Maria et al. 2017; Giorgi 2018.
22 Për më shumë rreth teknikave të ndërtimit, veçanërisht të periudhës romake në *Phoinike*, shih Benfatti, Patrignani 2023, 31-33.
23 Dëshmi vijnë nga qendra të ndryshme të territorit: nga Gjiri i Gramës dokumentohen dy mbishkrime (CIGIME 3, mbishkrimet nr. 178, 251); nga Apolonia janë zbuluar monedha bronzi të periudhës severiane (Gjongecaj, Picard 2004, 141, 143-144; Gjongecaj, Picard 2007, 102-104), si dhe një stelë funerare që paraqet një personazh në shoqërinë e objekteve me simbolikë që lidhet me kultin e Isis (CIGIME 1.2, nr. 197); nga Epidamne-Dyrrahu dokumentohet një llampë-anije që vjen nga amfiteatri (shih Shehi 2015, 303-328) dhe monedha të zbuluara gjatë gërmimeve të ndryshme në qytet (Meta 2015, 128-129, 403-404).
24 Për më shumë rreth tërmetit të gjysmës së dytë të shek. IV e.s. dhe të dhënave që dokumentohen edhe në qendra të tjera të territorit, si Butrint dhe fusha e Vrinës, apo Dyrrahu antik më në veri, shih Benfatti 2023a, 207-210.

REFERENCAT

Baldoni, Vincenzo 2023. "La 'prima' Phoinike: frammenti di ceramica attica della fine del VI–inizi V sec. a.C." *Phoinike* VII, 185–188.
Benfatti, Michael. 2023. "Il criptoportico e l'edificio a sostruzioni." *Phoinike* VII, 18–26.
Benfatti, Michael. 2023a. "La città tardoantica." *Phoinike* VII, 204–214.
Benfatti, Michael, and Matteo Patrignani. 2023. "Le tecniche edilizie: una nuova schedatura." *Phoinike* VII, 30–43.
Benfatti, Michael, and Belisa Muka. (në shtyp)."La casa degli intonaci di *Phoinike*. Definizione e sviluppo di modeli architettinici e decorativi", në J. Bogdani (edt.), *Abitare l'Epiro antico. Tipologie, modelli, e trasformazioni dell'edilizia residenziale nell'Epiro ellenistico e romano. Atti della giornata di studio internazionale,* Roma 15 gennaio 2024, Sesto Fiorentino
Bogdani, Julian, and Enrico Giorgi. 2011. "Un sito rustico nel territorio di Phoinike: l'insediamento di Matomara." *Phoinike* V, 105–116.
Budina, Dhimosten. 1972. "Antigonea." *Iliria* 2: 245–319.
Budina, Dhimosten. 1986. "Foinike në kërkimet e reja arkeologjike." *Iliria* 16 (2): 262–263.
Cabanes, Pierre. 1976. *L'Épire de la mort de Pyrrhos à la conquête romaine* (272–167 av. J.-C.). Paris.
Cabanes, Pierre. 1988. "Le développement des villes en Illyrie méridionale à partir du IVe siècle avant J.-C." *Bulletin de l'Association Française des Études Grecques* (BAntFr): 198–220.
Cabanes, Pierre. 1995. *Le monde hellénistique de la mort d'Alexandre à la paix d'Apamée* (323–188). Paris. PUF
Cabanes, Pierre. 1999."États fédéraux et *koina* en Grèce du Nord et en Illyrie méridionale", në P. Cabanes (edt.), *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité - III. Actes du IIIe colloque international de Chantilly, 16-19 octobre 1996* (1999), f. 373-382.
Cabanes, Pierre. 2007. "Appendice. Les Chaones et l'Épire, de l'indépendance à l'association." *Phoinike* IV, 227–238.
Cabanes, Pierre, ed. 2008. *Carte archéologique d'Albanie*. With M. Korkuti, N. Ceka, and A. Baçe. Tirana. Academy of Science of Albania
Cabanes, Pierre, and Faik Drini. 1997. *Corpus des inscriptions grecques d'Illyrie méridionale et d'Épire*. Vol. 1.2. Paris: École française d'Athènes.
Cabanes, Pierre, Faik Drini, and Miltiades Hatzopoulos. 2016. Corpus des inscriptions d'Albanie (en dehors des sites d'Épidamne-Dyrrhachion, Apollonia et Bouthrôtos). Vol. 3. Paris: École française d'Athènes.
Çondi, Dhimitër, Enrico Giorgi, Marco Podini, and Andrea Gamberini. 2002. "La 'Casa dei due Peristili' e la ripresa delle ricerche nel quartiere a terrazze di età ellenistica." *Phoinike* I, 63–91.
Dakaris, Sotirios, Anastasios Ph. Christidis, and Julia Vokotopoulou. 1993. "Les lamelles oraculaires de Dodone et les villes de l'Épire du Nord." In *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité II*, edited by Pierre Cabanes, 55–60. Actes du IIe colloque

international de Clermont-Ferrand, 25–27 octobre 1990. Paris.
D'Aprile, Margherita, and Isabella Leone. 2023. "Nuove osservazioni sulla stoà orientale di Phoinike: ipotesi di ricostruzione e analisi dei materiali e delle tecniche costruttive." *Phoinike* VII, 91–107.
De Maria, Sandro. 2002. "Il sito, la città, la storia." *Phoinike* I, 13–18.
De Maria, Sandro, and Luca Mercuri. 2007. "Testimonianze e riflessioni sul culto di Artemide a Phoinike." In Épire, Illyrie, Macédoine…, edited by Danièle Berranger-Auserve, 147–174. Clermont-Ferrand.
De Maria, Sandro, and Sidi Gorica. 2012. "Vitruvio e la Casa dei due peristili a Phoinike." *Ocnus* 20: 61–82.
De Maria, Sandro, and Sidi Gorica. 2018. "Spazi pubblici e spazi privati a Phoinike in età ellenistica: nuove ricerche." In *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité* VI, edited by Jean-Luc Lamboley, Luan Përzhita, and Altin Skënderaj, 541–554. Paris.
De Maria, Sandro, Julian Bogdani, and Enrico Giorgi. 2017. "Ricerca e tutela in territorio di frontiera. L'Epiro del nord fra età ellenistica e presenza di Roma." In *Paesaggi mediterranei di età romana*, edited by Giuseppe Mastrocinque, 49–62. Bari.
De Maria, Sandro, and Shpresa Gjongecaj, eds. 2002. *Phoinike I*: Rapporto preliminare sulla campagna di scavi e ricerche 2000. Bologna.
De Maria, Sandro, and Shpresa Gjongecaj, eds. 2003. *Phoinike II*: Rapporto preliminare sulla campagna di scavi e ricerche 2001. Bologna.
De Maria, Sandro, and Shpresa Gjongecaj, eds. 2005. *Phoinike III*: Rapporto preliminare sulla campagna di scavi e ricerche 2002–2003. Bologna.
De Maria, Sandro, and Shpresa Gjongecaj, eds. 2007. *Phoinike IV*: Rapporto preliminare sulla campagna di scavi e ricerche 2004–2006. Bologna.
De Maria, Sandro, and Shpresa Gjongecaj, eds. 2011. *Phoinike V*: Rapporto preliminare sulla campagna di scavi e ricerche 2007–2010. Bologna.
De Maria, Sandro, and Shpresa Gjongecaj, eds. 2015. *Phoinike VI*: Rapporto preliminare sulla campagna di scavi e ricerche 2011–2014. Bologna.
Funke, Peter, Nikola Moustakis, and Barbara Hochschulz. 2004. "Epeiros." *In An Inventory of Archaic and Classical Poleis*, edited by Mogens H. Hansen and Thomas H. Nielsen, 338–350. Oxford.Oxford University Press
Gamberini, Anna, and Enrico Giorgi. 2023. "Spunti di riflessione per una riconsiderazione della Casa dei due peristili." In *Phoinike* VII, 80–84.
Giorgi, Enrico, Marco Podini, Albana Meta, Federica Boschi, and Mauro Soldà. 2005. "L'edificio a portico del quartiere a terrazze." *Phoinike* III, 23–66.
Giorgi, Enrico, and Julian Bogdani. 2012. *Il territorio di Phoinike in Caonia: Archeologia del paesaggio in Albania meridionale. Scavi di Phoinike,* Serie monografica 1. Bologna.
Giorgi, Enrico. 2018. "Alcune riflessioni sull'Epiro settentrionale in età romana." *In Multa per Aequora: il polisemico significato della moderna ricerca archeologica. Omaggio a Sara Santoro*, edited by Marco Cavalieri and Cristina Boschetti, 983–1001. Louvain.
Gorica, Sidi. 2015. "La casa dei dipinti." *Phoinike* VI, 43–46.
Gjongecaj, Shpresa, and Olivier Picard. 2004. "Le monnayage d'Apollonia sous l'Empire romain." In *L'Illyrie méridionale et l'Épire dans l'Antiquité* IV, edited by

Pierre Cabanes and Jean-Luc Lamboley, 135–148. *Actes du IVe colloque international de Grenoble*, 10–12 octobre 2002. Paris. De Boccard
Gjongecaj, Shpresa, and Olivier Picard. 2007. "Les monnaies d'Apollonia." In Apollonia d'Illyrie 1: Atlas archéologique et historique, edited by Vangjel Dimo, Philippe Lenhardt, and François Quantin, 81–106. Rome. École française de Rome
Gjongecaj, Shpresa. 2011. "Monete di Butrinto e Phoinike in età romana: rinvenimenti da Phoinike e dal suo territorio", *Phoinike* V, f. 117-131.
Hammond, Nicholas G. L. 1967. *Epirus: The Geography, the Ancient Remains, the History and the Topography of Epirus and the Adjacent Areas*. Oxford. Claredon Press
Larsen, John A. O. 1968. *Greek Federal States: Their Institutions and History*. Oxford. Claredon Press
Leake, William Martin. 1835. *Travels in Northern Greece*. London. John Murray
Lepore, Giuseppe. 2019. "I teatri della Caonia (Epiro): spettacoli, culto o luogo di riunione?" In *Theaomai. Teatro e società in età ellenistica*, edited by Valeria Caminneci, Maria Clara Concetta and Maria Serena Rizzo, 63–70. Atti delle XI Giornate Gregoriane, Agrigento, 2–3 dicembre 2017. Florence.
Lepore, Giuseppe. 2022. "Gli spazi pubblici di Phoinike in Epiro: funzioni e trasformazioni dall'età ellenistica al medioevo." *Aquileia Nostra* 90–91: 21–34.
Lepore, Giuseppe. 2023. "La città romana." *Phoinike* VII, 195–203.
Lepore, Giuseppe, and Belisa Muka. 2018. *La necropoli meridionale di Phoinike: Le tombe ellenistiche e romane. Scavi di Phoinike*, Serie monografica 3. Bologna.
Lepore, Giuseppe, and Belisa Muka, eds. 2020. *L'archeologia della morte in Illiria e in Epiro: Contesti, ritualità e immagini tra età ellenistica e romana. Atti del Convegno Internazionale*, Tirana, 16–18 dicembre 2019. Rome.
Lepore, Giuseppe, and Belisa Muka. 2023. "Una nuova statua di Iside." *Phoinike* VII, 44–49.
Lepore, Giuseppe, and Belisa Muka, eds. 2023. *Phoinike VII: Rapporto preliminare sulla campagna di scavi e ricerche 2015–2022*. Studi Fenichioti III. Rome.
Lepore, Giuseppe, and Belisa Muka,""Le cd. "case sacre" tra Epiro, Sicilia e Magna Graecia", in J. Bogdani (edt.), *Abitare l'Epiro antico. Tipologie, modelli, e trasformazioni dell'edilizia residenziale nell'Epiro ellenistico e romano. Atti della giornata di studio internazionale,* Roma 15 gennaio 2024, Sesto Fiorentino, (në shtyp)
Lhôte, Éric. 2006. *Les lamelles oraculaires de Dodone*. Geneva. Droz
Meta, Albana. 2015. *Le monnayage en argent de Dyrrachion (375–60/55 av. J.-C.). Série RAFAL – Recherches archéologiques franco-albanaises* 1. Athens.
Muka, Belisa. 2023. "La città ellenistica." *Phoinike* VII, 189–194.
Muka, Belisa, and Michael Benfatti. 2023. "'Archeologia della guerra': la città dei militari." *Phoinike* VII, 164–182.
Nanaj, Astrit. 1989. "Gërmimet arkeologjike të vitit 1989: Foinike." *Iliria* 19 (2): 272–273.
Nanaj, Astrit. 1990. "Gërmimet arkeologjike të vitit 1990: Foinike." *Iliria* 20 (2): 265–266.
Quantin, Séverine, and François Quantin. 2007. "Le déplacement du temple d'Athéna Polias en Chaonie: remarques sur les cosiddetti 'temples voyageurs'." In *Épire, Illyrie, Macédoine… Mélanges offerts au Professeur Pierre Cabanes*, edited by Danièle

Berranger-Auserve, 175–196. Clermont-Ferrand.
Rinaldi, Elia. 2015. "L'agorà di Phoinike." *Phoinike* VI, 11–18.
Rinaldi, Elia. 2020. Agorai ed edilizia pubblica civile nell'Epiro di età ellenistica. DISCI Archeologia 25. Bologna.
Rinaldi, Elisa. 2023. "La stoà ellenistica: storia di una scoperta." *Phoinike* VII, 87–90.
Serino, Marco. 2021. "Alla ricerca di 'case sacre' tra Sicilia e Magna Grecia: per una nuova prospettiva sull'esperienza religiosa nell'Occidente greco, tra ipotesi di lavoro e riflessioni di carattere metodologico." *Thiasos* 10 (1): 37–77.
Shehi, Eduard. 2015. "Një kandil-anije nga Durrësi." *Iliria* 39: 303–328.
Ugolini, Luigi Maria. 1932. *Albania antica II: L'acropoli di Fenice.* Milan–Rome.
Villicich, Riccardo. 2018. *Il teatro di Phoinike. Scavi di Phoinike*, Serie monografica 4. Bologna.

About the Author

Prof. asoc. Dr. **Belisa Muka** është kërkuese shkencore në Institutin e Arkeologjisë që prej vitit 2000, e specializuar në antikitet. Ka kryer studimet master në Britaninë e Madhe dhe doktoraturën në Francë, me vlerësimin maksimal, duke u nderuar me çmimin ndërkombëtar Marc de Montalembert (2011). Fusha e saj e ekspertizës përfshin koroplatinë, arkeologjinë e religjioneve, të jetës ekonomike dhe të vendbanimeve. Është pjesë dhe bashkëdrejtuese e projekteve të rëndësishme ndërkombëtare arkeologjike, si Apollonia e Ilirisë, Phoinike, Dimal, Butrint etj. Autore e mbi 70 botimeve shkencore, është vlerësuar me çmimin kombëtar "Kërkuesi i ri më i suksesshëm" (2019). Ka një eksperiencë të gjerë në mësimdhënien universitare, ka ushtruar funksione drejtuese në Institutin e Arkeologjisë dhe është anëtare e bordeve kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).